



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

01 Nr. 06-29639/26
Klinë, datë: 10.09.2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i njëmbdhjetë publik për kornizen afatmesme buxhetore te vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me Asamblen Komunale te Femijëv me, datë 04.09.2026, ora 11:30, Salla e Kuvendit Komuna Klinë.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 07/09/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve. Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i Draft-Buxhetit i vitev 2027-2029 i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft-buxheti edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuar.

Takimi ka nisur në ora 11:30 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtori I arsimit z,Qemajl Sejdiq,drejtori i financave z,Faruk Smajli si dhe zyrtar i larte i DKA-së ,z,Astrit Muahxheri si dhe anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te komunës së Klinës

Nga Asambleja Komunale e Femijëve morën pjesë 13 persona, prej të cilëve, 3 meshkuj, dhe 10 femra

Shtojca 11– Fotografi nga dëgjim i njëmdhjetë për kornizen afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me Asamblen Komunale te femijevë te komunës së Klinës.



Takimi u hap nga zyrtari i lart i DKAS-së z,Astrit Muahxheri "

Përshëndetje të gjithëve!

I nderuar kryetar, të nderuar drejtorë të drejtorive, të nderuar anëtarë të kabinetit të kryetarit, të nderuar përfaqësues të OJQ-së **"Syri i Vizionit"**, të nderuar anëtarë të Asamblesë Komunale të Fëmijëve dhe ju, fëmijë të dashur,

Sot po zhvillojmë një takim të rëndësishëm në kuadër të dëgjimeve buxhetore. Pjesë e këtyre takimeve është edhe Asambleja Komunale e Fëmijëve, ku sot fëmijët e komunës sonë do t'i paraqesin disa nga kërkesat dhe propozimet e tyre.

Në fillim të kësaj mbledhjeje, fjalën ia kaloj kryetarit të komunës.

Ju faleminderit!

Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj,

Prezantoi Draft-Buxhetin e Komunës së Klinës për vitin 2027 para Asamblesë Komunale të Fëmijëve, në prani të përfaqësuesve të OJQ-së Syri i Vizionit gjatë takimit, Kryetari Elezaj u foli fëmijëve në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme për rëndësinë e buxhetit të komunës dhe mënyrën se si planifikohen dhe shpenzohen paratë e komunës për nevojat e qytetarëve. Ai shpjegoi se Draft-Buxheti për vitin 2027 përfshin planifikimin e mjeteve për fusha të ndryshme që janë të rëndësishme për jetën e qytetarëve, si arsimi, infrastruktura, shërbimet publike, kultura, sporti, mjedisi dhe fusha të tjera, një pjesë e veçantë e prezantimit iu kushtua fëmijëve dhe nevojave të tyre. Kryetari Elezaj theksoi se investimi në fëmijë dhe të rinj është investim në të ardhmen e Komunës së Klinës. Ai theksoi rëndësinë e krijimit të kushteve më të mira për mësim, zhvillim, aktivitete sportive, kulturore dhe hapësira të sigurta për fëmijët gjatë prezantimit, fëmijët patën mundësi të dëgjojnë se si përgatitet një buxhet komunal dhe pse është e rëndësishme që edhe ata të kenë mundësi të shprehin mendimet dhe kërkesat e tyre. Kryetari Elezaj i inkurajoi anëtarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve që të jenë aktivë, të japin ide dhe të marrin pjesë në diskutimet për çështjet që ndikojnë në jetën e tyre ai vlerësoi rolin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve dhe bashkëpunimin me OJQ-në Syri i Vizionit, duke theksuar se zëri i fëmijëve duhet të dëgjohet dhe të merret parasysh në planifikimet dhe aktivitetet e komunës.

Në fund, Kryetari Elezaj falënderoi fëmijët për pjesëmarrjen, pyetjet dhe interesimin e tyre, duke i siguruar se Komuna e Klinës do të vazhdojë të punojë për krijimin e mundësive dhe kushteve sa më të mira për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë.

Kërkesat e Asmblesë Komunale të Fëmijëve

Erza Agushi

Kryetare e Asamblesë Komunale të Fëmijëve

Kërkesat:

Ndërtimi dhe mirëmbajtja e trotuareve pranë shkollave, me qëllim rritjen e sigurisë së nxënësve.

Pajisja e shkollave me kabinete të Teknologjisë së Informacionit (TIK) dhe pajisje moderne teknologjike.

Furnizimi i shkollave me banka dhe karrige të reja dhe të përshtatshme për nxënësit.

Përmirësimi i kushteve higjienike dhe sanitare në shkolla.

Krijimi i hapësirave të sigurta dhe të përshtatshme për aktivitete kulturore, artistike dhe rekreative të fëmijëve.

Sigurimi i mjeteve dhe materialeve të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të nxënësve.

Taulant Gashi

Përfaqësues i Këshillit të Nxënësve në Shkollën “Ismet Rraci”

Kërkesat:

Pajisja e klasave me tabela dixhitale dhe mjete të tjera moderne të mësimdhënies.

Përmirësimi dhe rinovimi i infrastrukturës dhe hapësirave të brendshme dhe të jashtme të shkollës.

Furnizimi me banka dhe karrige të reja dhe të përshtatshme për nxënësit.

Pasurimi i bibliotekës së shkollës me libra të rinj dhe literaturë të përshtatshme për grupmoshat e nxënësve.

Ndërtimi dhe përmirësimi i fushave sportive dhe palestrave të shkollës.

Krijimi i hapësirave të gjelbra dhe këndeve rekreative për nxënësit.

Sigurimi i pajisjeve sportive dhe mjeteve të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve fizike.

Organizimi i më shumë aktiviteteve kulturore, sportive dhe edukative për nxënësit.

Përmirësimi i qasjes në internet dhe pajisjeve teknologjike për mësim më bashkëkohor.

Krijimi i një ambienti shkollor më të sigurt, gjithëpërfshirës dhe miqësor për të gjithë nxënësit.

Pergjigja e Kryetarit:

Faleminderit shumë për kërkesat dhe propozimet tuaja. Ato janë shumë të qëlluara dhe përbëjnë propozime të rëndësishme, të cilave do t'u kushtojmë një prioritet të lartë. Ne kemi planifikuar dhe kemi bërë ndarjet e nevojshme buxhetore për shumë prej kërkesave që parashtruat. Në planifikimet tona buxhetore janë përfshirë projekte për pajisjen e shkollave me tabela dixhitale, investime në objektet shkollore, ndërtimin dhe përmirësimin e fushave sportive, si dhe pajisjen e kabineteve të informatikës, biologjisë dhe kabineteve të tjera për këto projekte tashmë janë bërë ndarjet buxhetore dhe do të punojmë që ato të realizohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Megjithatë, për t'i trajtuar këto kërkesa sa më shpejt dhe për të ndërmarrë veprimet e nevojshme, ju kisha kërkuar që kërkesat tuaja t'ia përcillni edhe Drejtorisë përkatëse të Arsimit, si dhe drejtorëve të shkollave. Në këtë mënyrë, institucionet përkatëse do të kenë mundësi të intervenojnë më shpejt dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për realizimin e tyre, kërkesat dhe propozimet tuaja janë shumë të rëndësishme për ne dhe do t'i kemi parasysh me prioritet të lartë gjatë planifikimit dhe realizimit të projekteve tona.

Ju falënderoj për angazhimin, përkushtimin dhe kontributin tuaj në përmirësimin e kushteve në shkollat tona.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryesuesi I Kuvendit deklaroi:

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.

Mirëmbetshi!"

Takimi u mbyll në ora 12:00

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	10
Meshkuj	3
Totali	13

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu

